



UNIVERSITETI "KADRI ZEQA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: MENAXHIMI STRATEGJIK

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Menaxhmenti Strategjik
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i III-të, semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2 +2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha /lokacioni:	Ligjërata: Përcaktohet në çdo vit akademik Ushtime: Përcaktohet në çdo vit akademik
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr.Naim Mustafa
Detajat kontaktuese:	naim.mustafa@uni-gjilan.net
Përshkrimi i lëndës	Lënda do të fokusohet në ligjërimet koncepteve themelore të menaxhimit strategjik si proces i formulimit, zbatimit/implemtimit dhe vlerësimit e kontrollit të strategjisë. Ky kurs mbulon ose siguron njohuri për biznesin dhe menaxhimin e tij strategjik dhe funksionin integruar të të gjitha njohurive të marra në lëndë të tjera. Ai përcakton rolin dhe detyrat e menaxherit në një firmë, mënyrën e formulimit dhe zbatimit të një plani strategjik, llojet e strategjive që do të zbatohen. Kompetencat dalluese që duhet të kenë një biznes për të përballuar konkurrencën e tregut. Ky kurs synon të krijojë një vizion të së ardhmes së organizatës, për t'ia përshtatur aktivitetet e organizatës me mjedisin e saj.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është përfitimi i njohurive të themelore - një kuptim i qartë i koncepteve dhe parimeve kryesore të formulimit të strategjisë dhe analiza e konkurrencës; - një grup aftësish, mjetesh dhe teknikash analitike të dobishme për të analizuar strategjikisht në perspektivë një kompani të veçantë; - aftësia për të ndërtuar dhe integruar ide, koncepte dhe teori nga funksionet e marra më parë të integritit të të gjitha njohurive të fituara në lëndët e tjera; - aftësia për të menduar në mënyrë kritike dhe strategjike, - aftësia për të bërë çështjet strategjike në një mënyrë bindëse, duke pranuar që asnjë zgjidhje strategjike për një organizatë nuk është domosdoshmërisht e saktë; - aftësia për të punuar në ekipe, dhe aftësi prezantimi me gojë dhe me shkrim përmes analizës dhe raportimit të rasteve studimore.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> - Të përfitojnë njohuritë e nevojshme të koncepteve të menaxhimit strategjik për arritjen e qëllimeve afatgjata - strategjike të organizatës; - Të kuptojnë procesin e menaxhimit strategjik, natyrën e formulimit të strategjisë, aktivitetet e zbatimit dhe të vlerësimit e kontrollit të strategjisë; - Të zbatojnë konceptet e menaxhimit strategjik në praktikë përmes formulimit dhe zbatimit të planeve për arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike; - Në mënyrë kritike të analizojë, ndërlidhë dhe vlerësojë: <ul style="list-style-type: none"> - hartimin/deklarimin e vizionit, misionit dhe filozofisë së organizatës; - të analizimit dhe parashikimit të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të organizatës në identifikimin e faktorëve kyç; - përcaktimin e qëllimeve/objektivave afatgjata - strategjike të organizatës; - aplikimin e teknikave për analizat strategjike, duke përfshirë skenar në gjenerimin e alternativave strategjike; - analizën e industrisë/ degës dhe konkurrencës; - ti identifikojë llojet e ndryshme të strategjive, për të ndikuar në zgjedhjen dhe zbatimin e strategjisë; - çështjet kryesore të rishikimit, vlerësimit dhe kontrollit të strategjisë përmes shembujve konkret të rasteve studimore nga praktika e bizneseve vendore e ndërkombëtare.
---	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15 javë	30
Ushtrime teorike	1	15 javë	15
Kontaktet me mesimdhënësin / konsultimet	1	15 javë	15
Kollokfiime,seminare	2	2 ditë	4
Detyra të shtëpisë	1	15 javë	15
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15 javë	45
Përgatitja përfundimtare për provim	3	10 ditë	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	4	1 ditë	4
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	2	1 ditë	2
Totali			150 orë = 6 ECTS
Vërejtje: 1 ECTS /Kredi = 25 orë mësimore angazhim. Lënda i ka 6 ECTS / Kredi studentit duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë (150:25)=6 ECTS)			

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Mësimdhënia në këtë lëndë është e përqendruar në ligjërata dhe ushtrimin e detyrave në grup dhe në shtëpi. Metoda e punës dhe shpjegimit dhe do të përqendrohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dy (2) orë në javë ligjërata interaktive me pjesëmarrje të studentëve në procesin e mësimin, me prezantime individuale e grupore, analiza dhe diskutime në klasë etj. - Një (1) orë në javë ushtrime, diskutim grupore përmes analizave dhe rasteve të studimit apo detyrë (për orën e ushtrimeve) me qëllim të zhvillimit të aftësive dhe shkathtësive të tyre. - Përveç literaturës së obligative, studentët mund të kenë qasje në fondin e bibliotekës dhe bibliotekën elektronike.
Metodat e vlerësimit:	<p>Vijimi i rregullt dhe aktivitetet 1-10 pikë Detyrat e shtëpisë: 1-10 pikë Testi i parë: 1-20 pikë Testi i dytë: 1-20 pikë Provimi final: 1-40 pikë</p> <p>Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	1. Vasilika KUME „ <i>Menaxhimi Strategjik</i> “, <i>Teori, koncepte, zbatime</i> PEGI, Tiranë 2011;
Literatura shtesë:	2. Izet ZEQIRI “ <i>Menaxhimi Strategjik</i> ” “ <i>Analizë, formulim, implementim dhe kontrollë</i> ”; UEJ, Tetovë 2011; 3. Forest R. David, Fred R. DAVID „ <i>Strategic Management</i> “, <i>Concepts & Cases</i> 15th-Edition, Pearson Education, 2015;
Plani i dizajnuar i mësimin:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje /Prezantimi i lëndës
<i>Java e dytë:</i>	Vështrim i përgjithshëm i menaxhimit strategjik
<i>Java e tretë:</i>	Krijimi / Formulimi i vizionit, misionit dhe qëllimeve të organizatës
<i>Java e katërt:</i>	Analiza e mjedisit të jashtëm
<i>Java e pestë:</i>	Analiza e mjedisit të brendshëm
<i>Java e gjashtë:</i>	Formulimi i objektivave dhe llojet e strategjive
<i>Java e shtatë:</i>	Testi i I-rë
<i>Java e tetë:</i>	Identifikimi i alternativave strategjike
<i>Java e nëntë:</i>	Analiza, vlerësimi dhe zgjedhja e strategjisë
<i>Java e dhjetë:</i>	Zbatimi i strategjisë: struktura, proceset dhe sjelljet e organizatës
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Zbatimi i strategjisë: zhvillimi i strategjive funksionale
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Rishikimi, vlerësimi dhe kontrolli i strategjisë
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Menaxhimi i ndryshimeve në organizatë
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Testi II-të
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Udhëzime për studimin dhe analizën e shembujve studimorë nga praktika ekonomike / Konsultimet përfundimtare.
	Provimi final

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme.
- Studentët inkurajohen që të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve.
- Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shitesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutime për to.
- Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata.
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provime.
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.